



PROGRAMI I STUDIMIT MASTER I SHKENCËVE NË “DREJTËSI TRANZITORE”

BROSHURË INFORMUESE



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Hapja e programit Master në Drejtësi Tranzitore është mbështetur nga projekti “Ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve dhe profesionistëve shqiptarë në fushën e drejtësisë tranzitore”, i zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe i mbështetur financiarisht nga Republika Federale e Gjermanisë.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



Ministria Federale e Punëve të Jashtme

Shënim: Opinionet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë detyrimisht qëndrimin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Programi Master i Shkencave në Drejtësi Tranzitore në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës është krijuar për të konsoliduar kërkimin dhe mësimdhënien në fushën e drejtësisë tranzitore në Shqipëri. Përmes një kurrikule të gjithanshme dhe të integruar, Programi do trajtojë dimensionet kritike për të kuptuar drejtësinë tranzitore në Shqipëri, duke iu referuar kontekstit shoqëror, politik, institucional dhe ligjor në të cilin u krye tranzicioni nga e kaluara komuniste, aktorët kryesorë, dhe deri në çfarë mase është arritur apo mund të arrihet drejtësia. Programi do nxjerrë mësim nga krahasimet me shoqëritë e tjera që kalojnë nga lufta te paqja ose nga autoritarizmi te demokracia.

FORMA E STUDIMIT DHE DIPLOMA

Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Drejtësi Tranzitore" do të jetë një program me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë. Në përfundim të këtij Programi lëshohet diplomë e ciklit të dytë Master i Shkencave në "Drejtësi Tranzitore", në Fakultetin e Shkencave Sociale, në Universitetin e Tiranës, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

KURRIKULA E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Kurrikula e programit të studimit Master në fushën e Drejtësisë Tranzitore është bashkëkohore dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, e hartuar nga profesorë të Universitetit të Tiranës, nën këshillimin e tre profesorëve ndërkombëtarë të angazhuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Kurrikula ndërlidh tri fushat e studimit: sociologji, drejtësi dhe histori, dhe plotëson më së miri profilin e një studiuesi dhe kërkuesi të ardhshëm në fushën e drejtësisë tranzitore. Modulet analizojnë çështjet, masat, politikat dhe institucionet e drejtësisë tranzitore nga një këndvështrim ndërdisiplinor, përfshirë metodat e hulumtimit, dhe krijojnë hapësirë për analiza të thelluara në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Një element i veçantë i kurrikulës është theksimi i dimensionit praktik si brenda secilës lëndë, ashtu edhe në lëndë të veçanta të saj.

Në kuadër të projekteve për krijimin e Qendrës për Drejtësi dhe Transformim dhe Masterit në Drejtësi Tranzitore, Prezenca i ka dhuruar Qendrës për Drejtësi dhe Transformim/ Fakultetit të Shkencave Sociale, libra dhe materiale të tjera akademike të përshtatshme për t'u përdorur nga stafi i Qendrës, personeli akademik dhe studentët e Programit Master. Prezenca ka siguruar gjithashtu qasje në internet në disa revista akademike në fushën e drejtësisë tranzitore, ligjit, shkencave sociale dhe historisë.

LËNDË E MODULE TË KURRIKULËS DHE KREDITET PËRKATËSE

VITI I PARË I STUDIMEVE

■ Të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësia Tranzitore 8 ECTS

Kursi i aftëson studentët që të vlerësojnë, dallojnë dhe analizojnë aktet e sulmit, abuzimit, shkeljes dhe dhunimit të të drejtave të njeriut, sidomos në shoqëritë post-autoritare. Për shembull, krimet kundër njerëzimit që ndodhën në luftërat në ish-Jugosllavi ndryshojnë nga shkeljet e të drejtave të njeriut në kohën e diktaturës në Shqipëri. Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë se pse shkatërrimi i fshatrave, marrja peng e fëmijëve, prishja e infrastrukturës së një vendi dhe censura mediatike janë krime të rënda me të cilat merret drejtësia tranzitore. Duke njohur parimet e të drejtave të njeriut, normat dhe standardet morale dhe ligjore, studentët do të jenë në gjendje të bëjnë dallimin mes tyre dhe të kuptojnë përse masat e drejtësisë zbatohen në disa raste dhe në të tjera jo.

■ Drejtësia Tranzitore dhe Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut 8 ECTS

Studentët do të fitojnë njohuri në lidhje me bazat e Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe rëndësinë e tij për shoqëritë që kalojnë nga konflikti i armatosur ose regjimet autoritare në një rend politik demokratik, duke respektuar të drejtat e njeriut. Do të mësojnë mbi praktikën dhe jurisprudencën e organeve dhe mekanizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë për të drejtat e njeriut, duke u përqendruar në temat e rëndësishme për drejtësinë tranzitore, si dhe do të njihen me të drejtat 'thelbësore' që lidhen me drejtësinë tranzitore (e drejta për të vërtetën, drejtësinë, dëmshpërblimin dhe garancitë e mospërsëritjes). Studentët do të kuptojnë gjithashtu rolin e të drejtave civile dhe politike, dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore në kontekstin e drejtësisë tranzitore, si dhe do të analizojnë juridiksionin mbi mekanizmat e drejtësisë tranzitore. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka luajtur një rol të rëndësishëm në vendosjen e standardeve normative, duke kontribuar kështu si në juridiksionin e drejtësisë tranzitore, ashtu edhe në sundimin e ligjit.

■ **Drejtësia Tranzitore dhe Historia: Qasjet Teorike 8 ECTS**

Lënda është e ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë do t'i kushtohet aspektit teorik mbi drejtësinë tranzitore dhe historinë. Kjo pjesë do të synojë hedhjen dritë mbi zhvillimet e drejtësisë tranzitore në shek. 20-21, si dhe do të pasqyrojë debatet bashkëkohore të fushës. Gjatë kursit do të trajtohen diskurset mbi përgjegjshmërinë dhe pajtimin social, dhe do të nxitet mendimi se si drejtësia tranzitore mund të shërbejë për të bërë "drejtësi". Lënda synon të japë një hulumtim multidimensional të debateve aktuale politike, morale dhe teorike në fushën e drejtësisë tranzitore. Aspekt i qenësishëm i kursit do të jetë dhe analiza e efikasitetit të strategjive të përdorura nga shoqëritë post-totalitare/post-komuniste për t'u përballur me trashëgimitë e krimeve politike dhe të dhunimit të të drejtave të njeriut.

Pjesa e dytë e lëndës do të fokusohet në narrativat dhe diskurset kryesore mbi komunizmin dhe trashëgiminë komuniste në kontekstin e politikave të memories në Shqipëri. Në të do të shpjegohen aspektet e politikave të kujtesës dhe të përkujtimit të ngjarjeve të së kaluarës komuniste. Studentët do të mësojnë se si të ngrenë pyetje analitike mbi diskursin për kujtesën e komunizmit dhe drejtësinë tranzitore në Shqipëri postkomuniste, si dhe do të nxitin të angazhohen intensivisht në diskutime mbi tematikat e programit të lëndës.

■ **Gjinia dhe Drejtësia Tranzitore (me zgjedhje) 6 ECTS**

Studentët do të kuptojnë se pse gjinia ka rëndësi të trajtohet si çështje në drejtësinë tranzitore. Ata do të mësojnë se dhuna dhe konflikti mbështeten në norma kulturore që lejojnë përdorimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave, përfshirë përdhunimin si armë luftar. Gjithashtu studentët do të mësojnë se pse dhuna seksuale është krim luftar dhe duhet dënuar njësoj si krimet e tjera të luftës, sipas përcaktimit të legjislacionit ndërkombëtar penal dhe humanitar. Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje të zbatojnë masat e drejtësisë tranzitore në kuadër të gjinisë dhe do të dinë të përfshijnë dimensionin gjinor në të gjitha mekanizmat e drejtësisë tranzitore, juridike dhe administrative.

Drejtësia Sociale nëpërmjet Drejtësisë Tranzitore (me zgjedhje) 6 ECTS

Moduli synon të përmirësojë njohuritë e studentëve dhe të menduarit kritik për drejtësinë sociale. Gjatë kursit synohen të shqyrtohen shkaqet rrënjësore të pabarazisë, diversitetit dhe të drejtave të njeriut, si dhe të përgatiten studentët që të jenë në gjendje t'u përgjigjen sfidave bashkëkohore duke u nisur nga një analizë e Teorisë së Drejtësisë nga konceptet klasike në ato moderne të drejtësisë sociale. Gjithashtu, gjatë këtij kursi do të ilustronim dhe krahasojmë perspektivat e mendimtarëve si M. Sandel, Ch. Taylor, J. Habermas, John Rawls, M. Walzer, A. Macintyre, R. Dworkin, dhe të tjerë. Kjo njohuri teorike do të përdoret për analizën praktike të fenomeneve reale shoqërore, veçanërisht për sa i përket shumicës së rasteve komplekse, gjithashtu të ndikuara nga ekzistenca e regjimeve diktatoriale.

Tranzitologjia dhe Konsolidimi i Regjimit përmes Drejtësisë Tranzitore 8 ECTS

Në këtë lëndë studentët do të mësojnë se si fazat e njëpasnjëshme të ndërtimit të institucioneve mund të çojnë drejt demokracisë. Ata do të kuptojnë se deri në çfarë mase mekanizmat e drejtësisë tranzitore mund të rrisin ose pakësojnë besimin e qytetarëve te regjimi i ri, besimin e viktimave për drejtësi, besimin e viktimizuesve për gjykim të paanshëm, dhe shpresën për ngritjen e institucioneve.

Dëmshtëpërblimet, Kompensimet dhe Memorialet në Shoqërinë Post-autokratike 8 ECTS

Në këtë kurs shqyrtohen masat me në qendër viktimën, për të kuptuar se njohja e vuajtjeve të tyre është detyrim për shtetet. Këto masa ndreqin pasojat e dhunës masive dhe vendosin në vend të drejtat e njeriut, sipas detyrimeve të së drejtës ndërkombëtare. Viktima është personi që është dëmtuar, sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe ligjit penal ndërkombëtar, në një konflikt të armatosur, që është kërcënuar me jetën e vet dhe të të afërmeve për të dëshmuar kundër vetes, është abuzuar dhe dhunuar, ka vuajtur prej diskriminimit sistematik dhe përjashtimit shoqëror për shkak të etnisë, moshës, gjinisë, fesë, ideologjisë, gjuhës dhe aftësisë. Ky përjashtim bëhet duke iu mohuar arsimin e lartë, punësimin, lëvizshmërinë sociale. Viktimat janë burgosur, i janë nënshtruar trajtimit çnjerëzor, degradues dhe torturave, janë poshtëruar në forma të ndryshme dhe përjashtuar nga gëzimi i të drejtave themelore të njeriut. Prandaj duhen marrë masa që të zbutet efekti i pasojave të këtyre krimeve mbi viktimat. Këto masa kanë edhe efekt parandalues për të mos lejuar që mizori të tilla të ndodhin në të ardhmen.

E Drejta Ndërkombëtare Publike dhe Drejtësia Tranzitore 8 ECTS

Studentët do të marrin njohuri mbi sistemin dhe institucionet kryesore të së drejtës ndërkombëtare publike, do të mësojnë se si të përdorin metodat përkatëse për të analizuar dhe zgjidhur çështje të së drejtës ndërkombëtare, do të jenë në gjendje të identifikojnë burimet përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, si dhe të interpretojnë statutet dhe burimet e tjera të së drejtës ndërkombëtare në përputhje me metodat e vendosura të interpretimit. Studentët do të marrin gjithashtu një kuptim të detajuar të nëndegëve të veçanta të së drejtës ndërkombëtare publike, në veçanti ato që lidhen gjerësisht me drejtësinë tranzitore dhe temat e lidhura me të drejtën ndërkombëtare, si dhe do të fitojnë aftësi për të formuluar argumente ligjore për arritjen e rezulttit të caktuar. Gjatë këtij kursi studentët do të kuptojnë të drejtën ndërkombëtare në kontekstin e realiteteve ndërkombëtare.

Drejtësia Tranzitore dhe Shteti i së Drejtës në kontekstin shqiptar krahasuar me vendet post-komuniste në Evropë (me zgjedhje) 6 ECTS

Gjatë këtij kursi studentët do të analizojnë mekanizmat e drejtësisë tranzitore të zbatuara në Shqipëri. Studentët do të kuptojnë lidhjet e ndryshme midis koncepteve të drejtësisë tranzitore, shtetit të së drejtës dhe demokracisë, do të jenë në gjendje të testojnë marrëdhëniet midis llojeve të lustracionit dhe demokracisë, si dhe do të kuptojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike politikatat e drejtësisë dhe zbatimin e proceseve të drejtësisë. Studentët do të jenë gjithashtu në gjendje të njohin mekanizmat e drejtësisë tranzitore të përdorura në vendet post-komuniste të Evropës Lindore, do të vlerësojnë statuskuo-në e sistemeve gjyqësore, veçanërisht në lidhje me aktorët kryesorë në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që të identifikojnë mangësitë sistemike që kërkojnë reforma, si dhe do të jenë në gjendje të krahasojnë politikatat kalimtare të drejtësisë të zbatuara në vendet post-komuniste, kryesisht në rajon.

■ Drejtësia Tranzitore dhe E Drejta Penale Ndërkombëtare (me zgjedhje) 6 ECTS

Studentët do të kuptojnë pse disa nga abuzimet e të drejtave të njeriut dhe shkelje të ligjit humanitar konsiderohen sipas ligjit ndërkombëtar "krime ndërkombëtare", si përcaktohet ky term dhe si mund t'i ndjekin penalisht krimet ndërkombëtare gjykatat e ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare, do të kuptojnë origjinën dhe zhvillimin e së drejtës penale ndërkombëtare, si një fushë e specializuar e së drejtës ndërkombëtare publike dhe do të njihen me parimet dhe kornizat përkatëse ligjore, të tilla si Statuti i Romës dhe kornizat e brendshme për ndjekjen penale të krimeve ndërkombëtare, si dhe sinergjitë midis tyre, duke përfshirë atë që njihet si "plotësueshmëri". Studentët do të jenë gjithashtu në gjendje të analizojnë në mënyrë kritike të drejtën penale materiale ndërkombëtare dhe ta zbatojnë ligjin për probleme komplekse faktike, do të njihen me rastet e kaluara dhe ato të vazhdueshme të drejtësisë ndërkombëtare, do të kuptojnë ndikimin dhe perceptimet e tyre në shoqëritë në tranzicion, si dhe do të mësojnë rreth objektivave dhe ndikimit të drejtësisë ndërkombëtare, përfshirë mënyrën se si këto procese ligjore kryqëzohen me qëllimet e drejtësisë tranzitore, siç janë drejtësia, paqja dhe pajtimi në shoqëritë e prekura. Gjatë këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të analizojnë se si drejtësia ndërkombëtare lidhet dhe ndikon në të drejtat dhe interesat e viktimave.

VITI I DYTË I STUDIMEVE

■ Vetingu dhe Lustracioni: Roli për Demokratizimin 8 ECTS

Studentët do të kuptojnë dallimet mes vetingut dhe lustracionit, dallimet në mekanizma, aktorë dhe institucione. Vetingu dhe lustracioni në shoqëritë post-autokratike ndryshojnë nga ato të shoqërive pas lufte. Megjithatë, studentët do të jenë në gjendje të përcaktojnë se pse viktimizuesit duhet të vetohen dhe lustrohen dhe pse duhen parë lidhjet e tyre me të shkuarën autoritare. Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje të zbatojnë masat e drejtësisë tranzitore dhe të kuptojnë se si konceptet që lidhen me kujtesën dhe pajtimin kalojnë përmes proceseve historike, kulturore dhe politike.

■ Peisazhi Memoristik në Vendet e Evropës Post-Komuniste 8 ECTS

Në këtë kurs do të arrijmë të kuptojmë domethënien sociale të mbajtjes në kujtesë dhe të të përkujtuarit, si dhe rolin që ka hapësira publike në procesin e memories politike. Do t'u qasemi diskurseve mbi memorien, hapësirën publike, përkujtimin, identitetin kombëtar, pushtetin politik dhe historinë publike në procesin e të mbajturit mend dhe të përkujtimit. Fokusi i këtij kursi do të jetë marrëdhënia mes memories dhe peizazhit, me pikësynim trashëgiminë e komunizmit në vendet e Evropës Juglindore pas vitit 1989.

■ Metodatat Kërkimore në Drejtësinë Tranzitore 8 ECTS

Qëllimi i këtij moduli është të angazhojë studentët në aspektet empirike të kërkimit shkencor në drejtësinë tranzitore duke e kontekstualizuar atë në realitetin social dhe kulturor shqiptar, përmes një qasjeje ndërdisiplinore dhe përdorimit të metodave kërkimore shkencore. Studentët do të pajisen me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, në mënyrë që të jenë të aftë për të organizuar një studim në fushën e drejtësisë tranzitore, duke përdorur një gamë të gjerë metodash të mbledhjes së të dhënave dhe analizimit të tyre në një terren akademik ndërdisiplinor, si ai i drejtësisë tranzitore. Studentët do të njihen edhe me kornizat etike brenda të cilave zhvillohet kërkimi shkencor, si dhe me disa nga format e shprehjes dhe paraqitjes së rezultateve në fushën e drejtësisë tranzitore. Studentët do të pajisen me aftësitë e duhura metodologjike për të kryer një kërkim shkencor mbi çështje të ndjeshme dhe për të intervistuar kategori të ndryshme pjesëmarrësish në studim. Në përfundim të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të kryejnë një kërkim shkencor në fushën e drejtësisë tranzitore duke aplikuar një nga tri metodologjitë kërkimore shkencore kryesore.

■ **Drejtësia Tranzitore dhe Konteksti Social (me zgjedhje) 6 ECTS**

Në këtë kurs studentët do të mësojnë mbi mekanizmat dhe proceset që përdor drejtësia tranzitore në shoqëritë post-autoritare, duke shqyrtuar mundësitë e saj për të nxitur ndryshime sociale. Megjithatë, drejtësia tranzitore është një lëmë i ri shkencor, njësoj si historia sociale, dhe të dy lindën si rezultat i praktikave dhe aktiviteteve të mëdha të ushtruara nga aktivistët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për t'i rezistuar dhunimit të tyre të fuqishëm, si dhe zgjerimit të fokusit të historisë përtej përqendrimit tek elitat politike, por tashmë i orientuar drejt grupeve më të gjera sociale dhe politike. Sipas qasjes së Organizatës së Kombeve të Bashkuara ndaj drejtësisë tranzitore, kjo e fundit synon të trajtojë një sërë problematikash që kanë të bëjnë me të drejtat e mohuara, përfshirë ato ekonomike, sociale dhe të drejtat kulturore. Por, ende nuk ka një lëvizje tërësore që të përfshijë në proceset që kanë të bëjnë me drejtësinë tranzitore edhe dhunën ekonomike, sociale dhe të drejtat kulturore.

■ **Historia e së Vërtetës: Kërkimi i së Vërtetës dhe Mohimi në Përballjen me të Kaluarën (me zgjedhje) 6 ECTS**

Ky modul mbi "kërkimin e së vërtetës dhe mohimin" merr në analizë një nga sfidat thelbësore të historisë bashkëkohore: si të përballemi me historitë e regjimit totalitar dhe dhunën. Kërkimi i së vërtetës brenda fushës së drejtësisë tranzitore që në vitet '80-të ka qenë shqetësimi kryesor, qoftë kjo përmes hapjes së dosjeve zyrtare, komisioneve të së vërtetës, qoftë edhe zhvillimit të antinarrativës, si ato të shprehura në rastin e artit dhe teatrit. Kërkimi i së vërtetës në shumë raste ka qenë gjithsesi i politizuar dhe i rreshtuar në përputhje me agjendat politike. Ky kurs ka për qëllim të shqyrtojë se si historia na mundëson njohjen e shtresave të ndryshme në të kërkuarit e së vërtetës në drejtësinë tranzitore. Kjo do të përfshinte, siç vë re Paul Gready, të parit e të vërtetës si drejtësi, e të vërtetës si pranim dhe cilësimi me emra.

■ Praktikë Institucionale 12 ECTS

Praktika profesionale është një kurs formues që synon t'i përgatisë studentët që të ndërmarrin punë kërkimore në terren dhe të aplikojnë teorinë e kërkimit social përmes projekteve kërkimore empirike. Praktika profesionale organizohet kryesisht si punë terreni për mbledhjen e të dhënave, proces gjatë të cilit studentët mësohen të përcaktojnë një pyetje kërkimore dhe ta testojnë atë përmes pyetësorit të anketës/intervistës. Stadi i mbledhjes së të dhënave merr një rëndësi të veçantë në praktikën profesionale, pasi është parakusht për mbledhjen e "lëndës së parë" për analizën sociologjike të një dukurie sociale. Më pas studentët udhëhiqen në procesin e analizës së të dhënave dhe interpretimin e tyre bazuar te metodat analitike që mësojnë gjatë kursit dhe te paketat e përpunimit të të dhënave. Synimi është të ndihmohen studentët në njohjen e rolit të praktikës në krijimin e shprehive profesionale si kërkues në fushën e drejtësisë tranzitore.

Disa institucione kanë shprehur tashmë interes dhe gatishmëri për të bashkëpunuar me Fakultetin e Shkencave Sociale në lidhje me periudhën e praktikës për studentët e programit Master.

■ Tema/ Disertacioni 18 ECTS

Mikroteza është punimi kërkimor që studenti kryen në mënyrë të pavarur nën udhëheqjen e pedagogut përkatës.

PERSONELI AKADEMIK

Departamenti i Sociologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale është njësia bazë e ofrimit të programit të studimit. Për hapjen e Programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi Tranzitore janë angazhuar pesëmbëdhjetë pedagogë me kohë të plotë, pjesë e stafit akademik të Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Fakultetit të Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Një lektor do të angazhohet me kohë të pjesshme.

Të gjashtëmbëdhjetë pedagogët që do të angazhohen në mësimdhënien e këtij Programi janë staf akademik me grada dhe tituj shkencor. Në këtë program do të angazhohen tre staf akademik me titull Prof. Dr., katër staf akademik me titull Prof. Asoc. Dr., dy staf akademik me titull Doc. Dr., një staf akademik me titull PhD, dhe gjashtë staf akademik me titull Doktor i Shkencave.

MUNDËSI PUNËSIMI

Të diplomuarit në Programin Master i Shkencave në Drejtësi Tranzitore, pas mbarimit të këtij Programi do të jenë të përgatitur mirë për të ndjekur një karrierë në drejtësi tranzitore, në drejtësi penale ndërkombëtare dhe të drejta të njeriut, si në sferën kombëtare, ashtu edhe atë ndërkombëtare.

Studentët e diplomuar mund të punësohen në:

1. Institucione ndërkombëtare, në vend dhe jashtë, që trajtojnë çështje të drejtësisë tranzitore;
2. Organizata të pavarura në vend, si psh. Avokati i Popullit, Qendra për Nisma Ligjore Falas, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ;
3. Institucione kërkimore në fushën e historisë, studimeve të memories, si psh. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, etj;
4. Firma juridike që specializohen në drejtësi tranzitore;
5. Profesione jo-juridike që kërkojnë ekspertizë në ligj dhe zgjidhje konfliktesh, përfshirë gazetari, këshillim për politika sociale;
6. Këshilltar politik pranë qeverive në fushën e drejtësisë tranzitore, pranë ministrive të ndryshme, si ajo e jashtme, e mbrojtjes, etj;
7. Studiues dhe kërkues i pavarur në fushën e drejtësisë tranzitore, sigurisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
8. Universitete ose institucione të tjera të arsimit të lartë, si profesor në fushën e drejtësisë tranzitore.

VEPRIMTARIA AKADEMIKE

Veprimtaria akademike në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Drejtësi Tranzitore" fillon në vitin akademik 2021-2022.

APLIKIMI

Aplikantët e interesuar mund të aplikojnë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

KONTAKTE

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta"

Email: fshs.ut.info@gmail.com

Web: Fakulteti i Shkencave Sociale – Universiteti i Tiranës » Thirrje për hapjen e Masterit Shkencor "Drejtësi Tranzitore" në degën e Sociologjisë (kriteret dhe kuotat) (fshs-ut.edu.al)

Hapja e programit Master në Drejtësi Tranzitore është mbështetur nga projekti “Ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve dhe profesionistëve shqiptarë në fushën e drejtësisë tranzitore”, i zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe i mbështetur financiarisht nga Republika Federale e Gjermanisë.

